

VENDIM
Nr.538, datë 1.5.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E PAJISJEVE TË VEÇANTA, TË NGJYRAVE DHE SHENJAVE PËR
MJETET E POLICISË SË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Policia e Shtetit përdor mjetet e saj lëvizëse, të uniformuara dhe të pauniformuara, të ndara në:

- a) mjete tokësore;
- b) mjete ujore;
- c) mjete ajrore.

2. Mjetet e uniformuara, në përdorim të strukturave dhe punonjësve të Policisë së Shtetit kanë:

- a) ngjyrë blu të errët;
- b) targën me fjalët “POLICIA” dhe numrin, në përputhje me kërkesat e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë;
- c) logon e Policisë së Shtetit, të vendosur në çdo anë të dukshme të mjetit, dhe numrin e telefonit;

ç) pajisjet sinjalizuese, ndriçuese e zanore (sirena).

Ngjyra, targat dhe logoja në mjetet e uniformuara të Policisë së Shtetit janë të njëjta.

3. Mjetet e pauniformuara, në përdorim të strukturave dhe punonjësve të Policisë së Shtetit, kanë logon dhe targën “POLICIA”, të lëvizshme.

4. Të gjitha mjetet e Policisë së Shtetit kanë pajisje të veçanta, të domosdoshme për sigurimin e jetës dhe realizimin e detyrës.

5. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit miraton:

a) strukturat e Policisë së Shtetit, që do të përdorin mjete, të uniformuara dhe të pauniformuara në funksion të detyrës;

b) llojet, sasinë dhe afatin e përdorimit të pajisjeve, që do të kenë mjetet e Policisë së Shtetit, sipas funksionit që ato do të përdoren;

c) rregulloren e përdorimit të mjeteve dhe të pajisjeve, për struktura të veçanta të Policisë së Shtetit.

6. Çdo akt nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.

7. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha